



RAPORT TEMATIK

FEMIJET E HUMBUR NË SHQIPËRI



Përmbajtja

- 1. Hyrje**
- 2. Kush është ALO 116**
- 3. Pse një numër 116 000**
 - **Vizioni i ALO 116 000**
 - **Misioni dhe objektivat e ALO 116 000**
 - **Klasifikimi i rasteve të fëmijëve të humbur**
 - **Raste të fëmijëve të humbur të trajtuara nga ALO116 000**
 - **Shkaqet që ndikojnë tek fëmijët për të menduar largimin nga familja si zgjidhje**
- 4. Të dhëna të Policisë së Shtetit për fëmijët e humbur**
- 5. Profili i fëmijëve të humbur**
- 6. Konkluzione dhe rekomandime**
- 7. A i keni parë këta fëmijë?**

1. HYRJE

Çdo ditë në botë humbasin rreth 22.000 fëmijë apo 8 milion fëmijë në vit. 1 në 7 fëmijë të humbur ka më tëpër gjasa që të bëhet viktimë e trafikimit dhe shfrytëzimit. 30% e viktimave të trafikut ndërkombëtar të fëmijëve janë me origjinë nga vendet e Europës Juglindore. ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë raporton se çdo ditë një fëmijë mendon të largohet apo është larguar nga shtëpia në Shqipëri. Arratisja apo largimi nga shtëpia e fëmijëve dhe adoleshentëve nga disa orë në disa ditë është forma më e përhapur e manifestimit të refuzimit që fëmijët në Shqipëri i bëjnë situatave familjare, dhunës, abuzimit dhe neglizhimit.

Fatmirësisht shumica e çështjeve që denoncohen gjenden brenda 3-ditëve të para të shpalljes në kërkim, por kjo nuk do të thotë që problemi është i zgjidhur. Shumë fëmijë pasi gjenden dhe rikthehen në familje ndeshen sërish me të njëjtat situata konfliktuale, abuzimi dhe neglizhimi të cilat ndikojnë që fëmijët të largohen sërish nga mjedisi familjar apo kujdestar. Sa më shpesh që fëmijët largohen nga mjedisi familjar apo kujdestar aq më shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve janë ata. Disa studime kanë arritur në përfundimin se 25% e rasteve vuajnë një formë abuzimi gjatë humbjes, 13 % e rasteve të fëmijëve të larguar nga familja lëndohen fizikisht dhe 8% e tyre bien viktimë të dhunës seksuale. Një pjesë e fëmijëve dhe të rinjve që largohen nga mjedisi familjar përfshihen në aktivitete kriminale, gjithashtu vuajnë probleme të shëndetit mendor dhe depresionit.

Shqipëria pas vitive 90' është ndeshur me një natyrë shumë komplekse të çështjes së fëmijëve të humbur. Rrëmbimi, trafikimi, shfrytëzimi, pengmarrja kanë qënë disa nga fenomenet me të cilat bota e fëmijëve është ndeshur gjatë këtyre viteve në Shqipëri. Greqia dhe Italia kanë qënë destinacionet më të shpeshta për fëmijët. Nisur nga situatat e vështira ekonomike kemi patur disa precedent të shitjes së fëmijëve nga vetë familjarët apo të afërmit.

Një fëmijë i humbur shkakton gjithmonë tronditje në shoqërinë e çdo vendi. Humbja e një fëmijë është një situatë e cila prek dhe përfshin qindra familjarë dhe të afërm, të cilët humbasin vite duke u shqetësuar për fatin e njeriut të tyre të dashur dhe fatkeqësisht në disa raste ata nuk kthehen kurrë.

Fati i shumë fëmijëve të humbur nuk dihet. Shumë familje në Shqipëri jetojnë me ankthin e fatit të fëmijëve të tyre. Pas çdo fëmijë të humbur është një familje që vuan, është një shoqëri që vuan. Ajo çfarë i ndihmon familjet e këtyre fëmijëve të përballojnë këto situata shkatërrimtare është shpresa. Dhe për të mbajtur lart shpresën për kthimin e këtyre fëmijëve në shtëpi, nevojitet një ndërgjegjë më e lartë njerezore dhe një përgjegjë më efektive e të gjithë shtetit të mbrotjes së fëmijëve në vend.

2. KUSH ËSHTË ALO 116?

Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë – ALO 116 është një shërbim falas këshillimi dhe referimi për fëmijët. Ky shërbim komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116 111 – Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë; ALO 116 000 – Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët e Humbur. ALO 116 111 mbështetet nga zyra e UNICEF-Shqipëri dhe nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA Shqipëri). ALO 116 111 mbështetet dhe nga kompanite celulare: AMC, VODAFONE, EAGLE MOBILE, PLUS DHE AKEP.

Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë është një instrument që ka për qëllim të këshillojë fëmijët përmes telefonit dhe të referojë nevojat e tyre në institucionet përkatëse. ALO 116 si një shërbim i ri dhe unik në të gjithë Shqipëri synon ngritjen e standarteve dhe procedurave të duhuar në funksioan të një shërbimi cilësor për fëmijët.

Filozofia jonë është të përfshijmë fëmijët në referimin e nevojave dhe problematikave që ata i shqetësojnë dhe t'i ndërgjegjësojmë ata për të drejtat e tyre. Shërbimet e linjës synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet avokatësisë dhe mbështetjes së një sistemi që i përgjigjet fëmijëve që kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje.

ALO 116 është një mundësi për çdo fëmijë që të ndihmohet në një moment delikat të jetës së tij/saj. Linja e Këshillimit për Fëmijët është një vend, ku e drejtat e çdo fëmije për t'u dëgjuar, për tu shprehur, për tu informuar dhe për të informuar mbi situatën e tij/saj respektohet dhe ai/ajo merr shërbimin e duhur, të ofruar nga një staf i kualifikuar.

Shërbimi përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim përfshin dhe prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat e interesuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

Misioni i ALO 116 është tu gjendet pranë fëmijëve në momentet e tyre më të vështira, duke mbrojtur dhe avancuar kauzën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ne punojmë që të mbrojmë mirëqenien e fëmijës, nëpërmjet këshillimit me telefon, referimit dhe mbrojtjes pro-aktive të të drejtave të fëmijëve.

3. PSE NJË NUMËR 116-000?

116 - 000 është numri i harmonizuar Pan-Europian që ofron mbështetje të menjëhershme për çdo fëmijë që mund të ketë humbur apo që është larg të afërmeve. Më 15 shkurt 2007, Komisioni Europian njohu nevojën për domosdoshmërinë e një numri për të ndihmuar fëmijët e humbur të kthehen pranë familjeve, si dhe për të mundësuar ndihmën e duhur për prindërit që të gjejnë fëmijët e tyre. Komisioni europian (Vendimi nr.116 dhe nr.698 i datës 15 Shkurt dhe 29 Tetor të 2007), ka rezervuar fillimisht numrin 116 për shërbime që kanë impakt social në jetën e komunitetit. Në vitin 2008, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike Europiane e bëri atë funksional dhe e përkufizoi “ 116000- Linjë Telefoni direkte për Fëmijët e Humbur”. Linjat e Telefonit për Fëmijët e Humbur menaxhohen nga OJF-të dhe mbështeten nga Bashkimi Europian. Në Shqipëri Linja Për Fëmijët e Humbur mbështetet nga zyra e UNICEF dhe CRCA. Për momentin kjo linjë është funksionale në 15 vende të BE-se dhe 3 vende të Ballkanit.

Në nëntor të vitit 2010, UNICEF, Qendra Ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur dhe Shfrytëzuar (ICMEC) organizoi në bashkëpunim me CRCA dhe ALO 116 takimin e parë me të gjithë partnerët kryesorë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar për ti dhënë rrugë krijimit të Qendrës Kombëtare për Fëmijët e Humbur në Shqipëri. Që nga viti 2010 ALO 116 000 funksionon si Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe si Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët e Humbur në Shqipëri.

3.1 VIZIONI I ALO 116 000

Shkaku i humbjes apo i zhdukjes së një fëmijë përfshin situata të ndryshme të rrëmbimit, dhunës dhe abuzimit duke përfshirë dhe shfrytëzimin seksual. Vizioni i Linjës për Fëmijët e Humbur në Shqipëri është se të gjithë fëmijët duhet të mbështeten nga një sistem efektiv dhe tërësor i mbrotjes së fëmijëve duke marrë të gjitha masat për t'i fuqizuar dhe mbrojtur ata ndaj çdo situatë të dëmshme dhe risku që ndikon në humbjen e fëmijëve.

3.2 MISIONI DHE OBJEKTIVAT E ALO 116 000

Misioni ynë është të kontribuojmë në zhvillimin e efektshëm të sistemit të mbrotjes së fëmijëve në:

- Parandalimin e fenomenit të humbjes së fëmijëve;
- Mbështetjen e fëmijëve të humbur dhe familjeve të tyre;
- Mbrotjen e fëmijëve nga çdo lloj situatë rrisht që ndikon në humbjen e fëmijëve;
- Mbledhje e të dhënave të vazhdueshme për fëmijët e humbur, shfrytëzuar dhe trafikuar;
- Informim dhe ndërgjegjësim të publikut në lidhje me çështjet e fëmijëve të humbur në Shqipëri;
- Referimin e rasteve;

3.3 KLASIFIKIMI I RASTEVE TË FËMIJËVE TË HUMBUR

“Fëmijë i humbur” konsiderohet çdo rast kur një fëmijë largohet nga kujdesi prindëror / kujdestar, por që nuk dihen rrethanat e largimit ose zhdukjes së tij/saj dhe nuk ka asnjë informacion ose të dhënë mbi mirëqenien (jetën shëndetin) apo vendndodhjen aktuale të tij.

Fëmijë të humbur në situatë rreziku konsiderohen rastet si më poshtë:

- Fëmija është nën moshën 14 vjeç dhe nuk ka informacion rreth rrethanave të largimit apo vendndodhjes së tij/saj;
- Fëmija është i moshës 14 – 18 vjeç, por njihet nga strukturat policore apo ka informacion se ai është përdorues i/e alkolit, drogës, apo i/e përfshirë në aktivitete të mëparshme kriminale si l ekpozuar ndaj rreziqeve dhe fenomeneve të cilat ndikojnë në shkëputjen e kontakteve me të afërmit;
- Fëmija vuan nga sëmundje që trajtohet me medikamente në mënyrë të vazhdueshme apo ka probleme të shëndetit mendor & psikologjik, etj,. Çdo fëmijë i/e larguar nga shtëpia për shkak se është viktime e dhunës në familje;
- Çdo fëmijë i rrëmbyer ose që ka të dhëna që të bëjnë të besosh se fëmija mund të jetë rrëmbyer, për qëllime shfrytëzimi apo shkaqe të tjera që rrezikojnë mirëqenien apo jetën e fëmijës;
- Fëmijë i marrë në mënyrë të padrejtë është çdo fëmijë i marrë nga njëri prind/kujdestar në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës, duke e larguar atë prej personit që ushtron autoritetin prindëror ose që i është besuar për rritje dhe edukim;

Cfarë bën ALO 116-000 në rastet e fëmijëve të humbur?

ALO 116-000 funksionon me një qendër thirrjeje dhe sipas të dhënave që vijnë në qendrën e thirrjeve, bëhet klasifikimi i telefonatave. Në këtë klasifikim përfshihen:

- Lokalizimi fizik i fëmijëve (vendodhja e tyre) duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizatat partnere kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe vetë fëmijën;
- Telefonata për këshillim nëpërmjet të cilave u ofrohet këshillim psikosocial fëmijëve të humbur, rrëmbyer, trafikuar apo fëmijëve që shfaqin tentativa largimi nga familja por gjithashtu edhe prindërve dhe të afërmeve të tjerë të fëmijëve të humbur, rrëmbyer, trafikuar apo fëmijëve që janë larguar nga shtëpia;
- Shkëmbim informacioni me Policinë e Shtetit bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2011;
- Shkëmbim informacioni dhe koordinim me linjat europiane të fëmijëve të humbur, rrjetin ndërkombëtar të fëmijëve të humbur GMCN dhe organizata të shoqërisë civile;
- Referim dhe raportim të rasteve;

3.4 RASTE TË FËMIJËVE TË HUMBUR TË TRAJTUARA NGA ALO


Efekti i humbjes së një fëmijë në ambjentin familjar është shumë i madh. Pasojat në shëndetin emocional dhe fizik janë të medha nga shqetësimi për fatin e njeriut të dashur. ALO 116 000 ka mbështetur 11 familje dhe të afërm të këtyre familjeve me shërbimet e saj por prapë shumë familjar të rasteve që edhe ALO 116 000 ka trajtuar nuk kanë marrë shërbime mbështetëse sepse nuk kanë patur akses në shërbime mbështetëse emocionale të specializuara për rastet e humbjes së fëmijëve.


Përveç aspektit emocional shumë familje vuajnë edhe aspektin ekonomik sepse impenjohen dhe investojnë në kërkime dhe hetime private, gjë e cila në shumicën e rasteve ua rëndon më shumë situatën. Familjarët e fëmijëve të humbur humbasin edhe punën si rezultat i impenjimit në kërkime dhe si rezultat i mospërshtatjes më vijëmisinë e aktiviteteve të mëparshme pas humbjes së fëmijës.

Gjatë këtyre 6 viteve të funksionimit të ALO 116 000 janë trajtuar në mënyrë direkte **11** raste të fëmijëve të humbur. Referimet janë bërë kryesisht nga organizatat partnere të shoqërisë civile, media dhe të afërm të fëmijëve të humbur.

Falë një punë intensive dhe të mirëkoordinuar me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtar **6** çështje janë zgjidhur me sukses ku **4** prej tyre janë zgjidhur brenda 24 orëve të para të kërkimit dhe mbledhjes së informacionit operativ dhe **2** çështje të tjera janë zgjidhur me sukses 1 jave pas denoncimit dhe mbledhjes së informacionit. **5** çështje vazhdojnë të mbeten të hapura.

Tipologjia e rasteve të raportuara në ALO 116 000






Në grafikët e mësipërm janë pasqyruar kategoritë kryesore të rasteve të cilët janë trajtuar në Qendrën Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe ALO 116 000. Siç shikohet edhe nga grafikët e mësipërm tipologjia e rasteve të trajtuara është e ndryshme. Rastet e gjetura janë klasifikuar në kategorinë e **-I larguar nga familja-2 raste,-Humbje Kontakti-1 rast, -I humbur I neglizhuar-1 rast, -I humbur nderkufitar-1 rast, -I rrembyer për shfrytëzim seksual-1 rast**, ndërsa çështjet që vazhdojnë të jenë të hapura janë klasifikuar në kategorinë **-I humbur-2 raste, -I rrembyer-1 rast, -Rrembim prindëror-2 raste**.

3.5 SHKAQET QË NDIKOJNË TEK FËMIJËT PËR TË MENDUAR LARGIMIN NGA FAMILJA SI ZGJIDHJE

Fëmijë të larguar nga familja klasifikohen të gjithë fëmijët të cilët largohen nga mjedisi familjar, nga institucioni rezidencial apo nga personat të cilët janë kujdestar të fëmijëve.

Fëmijët zakonisht largohen nga situatat e abuzimeve, neglizhimit dhe konflikteve në ambjentin familjar apo në institucionin ku ata janë vendosur. Disa fëmijë të tjerë vendosin të largohen nga mjedisi ku ata jetojnë për shkak të shfrytëzimit me të cilin ata përballen. Sipas Rrjetit të Fëmijëve të Humbur në Europë-MCE, 1 në 6 fëmijë i cili largohet nga mjedisi familjar fle në kushte shumë të këqija, 1 në 8 fëmijë detyrohet të vjedhë apo të lypë për të mbijetuar dhe 1 në 4 fëmijë ekspozohet ndaj risqeve që i kanosin seriozisht jetën. Fëmijët që largohen nga mjedisi familjar shpesh bien viktimë e abuzimit seksual dhe abuzimit me substanca narkotike dhe me alkool. Ata janë 9 herë më shumë të ekspozuar ndaj mendimeve vetvrasëse.



Ajo çfarë është e rëndësishme në lidhje me episodet e largimit të fëmijëve nga familja është se ai vjen më shumë si pasojë, simptomë apo tregues i një problemi, se sa një problem në vetvete. Studimet na tregojnë se asnjë shoqëri nuk është immune nga fenomeni i largimit të fëmijëve dhe adoleshentëve nga mjedisi familjar apo kujdestar. Gjatë periudhës **2009-2014** pranë ALO 116 janë trajtuar më shumë se **490** raste që e kanë menduar largimin nga shtëpia si një mënyrë reagimi ndaj problemeve në të cilët ata janë të ekspozuar.

Siç shikohet edhe nga grafiku i mësipërm marrëdhëniet problematike familjare me **215** raste janë shkaku më i madh që i bënë fëmijët të mendojnë largimin nga shtëpia si një zgjidhje dhe si një veprim i cili do të tërheqë vëmendjen e prindërve për të normalizuar marrëdhëniet. Nga të dhënat e mbledhura nga ALO 116 000 marrëdhëniet afektive kanë një impakt të rëndësishëm dhe ndikim që influencon ndërmarrjen e iniciativave për tu larguar nga familja. Kjo ndodh për shkak se shumë adoleshentë duan që të jenë në qendër të vëmendjes në shkollë apo në rrethin e tyre shoqëror, por kur marrëdhëniet e tyre afektive nuk shkojnë ashtu siç ata i parashikojnë ata ndjehen keq, kanë një vetvlerësim të ulët, ndjehen të parëndësishëm. Për ta fshehur aspektin e tyre emocional nga familja, adoleshentët nuk shkojnë në familjen e tyre nga disa orë në disa ditë për t'iu shmangur përballjes me familjarët.

Siç e kemi përmendur edhe mësipërm fëmijët zgjedhin të largohen nga familja dhe ambejntët e tjera në të cilat janë vendosur edhe kur ndeshen dhe përballën më dhunën fizike, emocionale dhe neglizhimin. Numri i rasteve të raportuara në ALO 116 000 të cilat e kanë menduar largimin nga familja për t'iu shpëtuar dhunës fizike dhe abuzimit emocional është **118** ndërsa **48** raste kanë raportuar se si pasojë e neglizhimit apo krahasimit që prindërit, familjarët apo të afërmit iu bëjnë atyre mendojnë që të largohen nga familja për t'u mos u përballur më me ata. Shumë fëmijë mendimin për tu larguar e kanë nxitje të momentit si reagim ndaj situatës e cila i ka ndikuar. Kur këta fëmijë dhe të rinj janë pyetur nga këshilluesit për planet e tyre se ku do shkojnë, si do ta menaxhojnë veten pas largimit apo ku do mbeshteten ata nuk kishin asnjë përgjigje dhe asnjë plan.

Kjo do të thotë që shumë fëmijë përfundojnë në rrugë ku problemet me të cilat duhet të përballen janë më të ashpra se realiteti që ndeshin në familjen e tyre. Në të shumtën e rasteve kur fëmijët dhe të rinjtë janë larguar nga familja kanë rënë viktime të shfrytëzimit seksual, abuzimit me substanca narkotik si dhe abuzimit dhe dhunës.


4. TË DHËNA TË POLICISË SË SHQIPTARË PËR FËMIJËT E HUMBUR

ALO 116 000 ka praktike pozitive të bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, praktike kjo e bazuar edhe në marrëveshjen e përbashkët të nënshkruar në vitin 2011 për shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë për gjetjen dhe rikthimin e fëmijëve të humbur. Bazuar në këtë marrëveshje por edhe në bashkëpunimin reciprok bazuar në interesin më të lartë të sigurisë fizike të fëmijëve, institucioni i parë që futet në veprim në rastet e humbjes së fëmijëve është Policia e Shtetit si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar. Gjithashtu në Policinë e Shtetit ka struktura të posaçme që merren me çështjet e fëmijëve të humbur. Burimi më i madh i të dhënave në lidhje me fëmijët e humbur janë të dhënat e Policisë së Shtetit.

Edhe pse policia është aktori kryesor në rastet e humbjes së fëmijëve është i rëndësishëm fakti se niveli i përfshirjes se menjëhershëm të policies varet nga disa faktorë. Në disa raste policia futet menjëherë në veprim dhe ka një nivel të lartë reagimi kjo në varësi të specifikës së rastit por edhe bazuar në aspektin logjistik të cilin zotëron policia lokale në zonën ku denoncohet humbja e një fëmijë. Ka një lloj “neglizhence” në rastet kur denoncohet largimi i një fëmijë nga familja i cili mund të jetë një rast i njohur dhe i përsëritur për policinë. Në raste të tilla jo vetëm praktika e Policisë Shqiptare por edhe disa polici të shteteve europiane presin mesatarisht nga 8-48 orë që fëmija të rikthehet vetë në familje dhe nëse fëmija nuk rikthehet me vullnetin e tij atëherë policia nis kërkimet gjithnjë pasi është bërë vlersimi i rrethanave paraprake të ngjarjes.


Të dhënat e marra nga Policia e Shtetit dhe të pasqyruara në grafikët e mëposhtëm tregojnë raportin gjinor të fëmijëve të humbur, efektshmërinë e reagimit të policisë në zbulueshmërinë dhe kthimin e fëmijëve në mjedisin familjar si dhe numrin dhe tendencën e humbjes së fëmijëve në Shqipëri për periudhën 2009-2014. Veç të dhënave të mësipërme janë mbledhur dhe të dhëna për veprat penale të regjistruara nga policia që ndikojnë në humbjen e fëmijëve në Shqipëri.¹

¹ Të dhënat janë marrë bazuar në kërkesën që ALO 116 000 i ka dërguar Drejtorisë së Policisë me Nr.prot 0205 date 26.01.2015, “Kërkesë për të dhëna në lidhje me numrin e fëmijëve të humbur në Shqipëri”




Ne grafikun e mësipërm paraqiten rastet e raportuara në Policinë e Shtetit për periudhën **2009-2014**. Për këtë periudhë janë raportuar **444** raste të humbjes së fëmijëve që është pothuajse në numër të përafërt më numrin e rasteve të raportuara nga ALO 116 000 në lidhje me mendimet dhe tentativat për t'u larguar nga ambienti familjar. Siç shikohet edhe nga grafiket fëmijët vajza janë më të ekspozuara ndaj fenomenit të humbjes dhe zhdukjes me **67%** të rasteve apo **296** raste gjithsej. Fëmijët djem për këtë periudhë përbëjnë rreth **33%** të rasteve të policisë me **148** çështje të trajtuara. Niveli i zbulueshmërisë për gjetjen dhe kthimin e tyre në mjedisin familjar arrin në **88%** që është një nivel relativisht i mirë, ndërkohë që sipas këtyre të dhënave **49** fëmijë rezultojnë të humbur dhe janë në kërkim.

Fëmijë të humbur 2009-2014



Siç shikohet edhe nga grafiku i mësipërm rritja e numrit të rasteve të fëmijëve të humbur të raportuara në polici është me ritme shumë të shpejta. Vetëm për periudhën **2009-2014** numri i rasteve të ndjekura nga policia pothuajse është **6-fishuar**. Sipas raportimeve pranë ALO 116 000 përkëqësimi i situatave konfliktuale familjare, marrdhëniet afektive, abuzimi fizik, abuzimi emocional, neglizhimi janë faktorë të cilët ndikojnë shumë që fëmijët të ndërmmarin iniciativa për tu larguar nga ambjenti familjar. Duke parë këtë trend rritjeje të numrit të raportimeve, situata është vërtet shumë shqetësuese. Niveli i zbulueshmërisë dhe i rikthimit në familje të këtyre rasteve varion nga **78%** në **100%** në vitin 2011. Numri i rasteve të fëmijëve të humbur në kërkim për periudhën 2009-2014 është **49**.

Vepra penale që i referohen rasteve të humbjes së fëmijëve



Në grafikun e mësipërm janë paraqitur veprat penale më të përhapura të cilat përbëjnë shkak dhe indicie që rastet të klasifikohen fëmijë i humbur apo i larguar. Vepra penale më e përhapur është - Marrja e padrejtë e fëmijës Neni 127 i Kodit Penal “Marrja e padrejtë e fëmijës, duke e larguar prej personit që ushtron autoritetin prindëror ose që i është besuar për rritje dhe edukim, si dhe mosdorëzimi i fëmijës prindit tjetër në zbatim të vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”. Kësaj vepre penale i përkasin gjithsej **86** raste nga të cilat **46** i referohen fëmijëve vajza. Për sa i përket rasteve të trafikimi të të miturve parashikuar si vepër penale në Nenin 128/b të Kodit penal janë referuar në polici **37** çështje nga të cilat **19** raste i referohen fëmijëve vajza. Në të dyja keto kategori që kanë rastet më të medhaja të veprave penale që i referohen çështjes së Fëmijëve të Humbur, fëmijët vajza janë më të ekspozuara. Në përfundim të analizës së këtyre veprave rezulton se fëmijët vajza janë më të

ekspozuara ndaj veprave: Trafikimi i të miturve, Rrëmbim dhe mbajtja peng e personit, Rrëmbim dhe mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese dhe Marrja e padrejtë e fëmijës. Fëmijët e grupmohës nën 14-vjeç janë më të ekspozuar dhe me të pambrojtur ndaj këtyre veprave.

5. PROFILI I FEMIJEVE TE HUMBUR NE SHQIPERI

Ishte 12 mars 1992 kur vogëlushja Juljana Hoxha në atë kohë 6-vjeçe gjendej pranë vendit më të sigurtë të saj, shtëpisë. Silueta e një makine me shpejtësi afrohet dhe dikush e tërheq brënda. Ky ishte detaji i fundit i parë nga dëshmitarët për vogëlushen Juljana Hoxha.

3 vite më vonë kur akoma nuk kishte asnjë të dhënë për Juljana Hoxhën ngjarja përsëritet me të njëjtat detaje dhe dinamike por këtë herë ndryshon qyteti, ngjarja zhvendoset në Durrës. Vogëlushi 4-vjeçar Nuz Luga në një dite qershori të vitit 1995 rreth orës 11 rrëmbehët pranë shtëpisë së tij në qytetin e Durrësit. Ajo çfarë u pa nga dëshmitarët ishte përsëri silueta e një makine me shpejtësi dhe një dorë që zgjatet dhe rrëmben vogëlushin. Pas 2 muajve për këtë ngjarje arrestohet një çift dhe denohen por vogëlushi nuk u gjend asnjëherë.

Pranverë e vitit 2010 në një fshat të largët të veriut të Shqipërisë Zapod, Kukes vogëlushja 6-vjeçare Bleona Mata shikohet për herë të fundit nga familjarët e saj vetëm pak metra larg shtëpisë. Që nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e saj. Ajo është zhdukur nderkohe që shkante në mal në një fshat pranë ku ajo supozohej të takonte 5 vjaza të tjera ndër të cilat edhe hallen e saj.

Po në vitin 2010 denoncohen dy fëmijë të humbur, motër e vëlla nga nëna e tyre. Pavarësisht se ngjarja është shënuar në Austri nëna mendon se fëmijët e saj Isa Nela dhe Mirjeta Nela janë fshehur në Shqipëri. Ngjarja është edhe më dinamike për shkak se bashkë me fëmijët është zhdukur dhe babai i tyre. Sipas nënës, fëmijët janë rrëmbyer nga babai dhe fshihen në Shqipëri. Që nga viti 2010 nuk dihet asgjë për fatin e Isës, Mirjetës dhe babait të tyre.

Korrik 2011, djaloshi 15-vjeçar Marte Bejaj në një të shtunë del nga shtëpia për të luajtur me shokët në fshatin Fitore, Vlore. Për herë të fundit është parë pranë shtëpisë në drejtim të fushës së fshatit. Që nga ajo ditë nuk ka asnjë lajm për Marteon.

Nëntor 2012 Juljan Çela del nga shtëpia dhe nis drejt qendrës së internetit pranë banesës së tij në Laprakë, Tiranë. Qendra e internetit ishte hera e fundit ku u pa Juljan Çela.

E përbashkëta e të gjithë këtyre rasteve është zhdukja në mënyrë të mistershme por edhe vendi i ngjarjes. Të gjitha janë ngjarje që kanë ndodhur pranë ambjenteve ku fëmijët dhe familjet i konsiderojnë si më të sigurtat për fëmijët e tyre, pranë shtëpive dhe lagjeve. Për asnjërin nga këto raste organet ligjzbatuese nuk kanë informuar publikisht për pistat dhe ecurine e hetimeve. Vetëm njëra nga këto ngjarje është gjysëm e zbardhur, rasti i Nuz Lugës ku janë dënuar vetëm autorët e rrëmbimit të cilët gjatë procesit gjyqësor kanë deklaruar dhe bashkëpunëtorët dhe detaje të tjera të krimin por fëmija nuk u gjend asnjëherë. 6 nga këto 7 raste janë fëmijë të cilët në kohën në të cilën kanë ndodhur ngjarjet kanë qenë më të vegjël se 10 vjeç.

25 Maj-Dita Ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur



25 Maj - Dita ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur, është një ditë ku njerëzit dhe shoqëria në mbarë botën kujtojnë fëmijët e humbur, ata fëmijë të cilët kanë qënë viktimat të trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit, si dhe mbeshtesin përpjekjet e familjarëve për të gjetur fëmijët e tyre.

Qëllimi kryesor i Ditës Ndërkombëtare për Fëmijët e Humbur është të inkurajojë të gjithë institucionet dhe shoqërinë që të mendojnë për fëmijët e humbur dhe për të përhapur mesazhe shprese.

Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur në Shqipëri në bashkëpunim me ALO 116 000 dhe CRCA çdo vit organizojnë aktivitete në kuadër të kësaj dite ku aktivitetet e 25 Maj-it të viteve 2013 dhe 2014 kanë patur një impakt të madh në mbarë opinionin publik shqiptar.

25 Maj 2013-ALO 116 000-Linja Kombëtare për Fëmijët e Humbur si anëtare e Rrjetit Global për Fëmijët e Humbur dhe Qendra për Mbrotjen e të Drejtave të Fëmijëve CRCA organizuan Zinxhirin Njerëzor përpara Kryeministrit, për të kërkuar një vëmendje më të madhe të institucioneve publike dhe shoqërisë ndaj çështjes së fëmijëve të humbur në Shqipëri.

25 Maj 2014 për të kërkuar një angazhim më të madh të institucioneve, agjencive ligjzbatuese dhe shoqërisë ndaj çështjeve të fëmijëve të humbur u organizua Marshimi në mbështetje të Fëmijëve të Humbur përpara Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme ku këtij marshimi iu bashkuan prindërit dhe familjarët e fëmijëve të humbur.

Cdo 25 Maj ALO 116 000 iu kërkon institucioneve kryesore angazhim më serioz për një sërë çështjesh si më poshtë:

- Intesifikimin e kërkimeve për gjetjen e fëmijëve të humbur;
- Krijimin e një procedure standarte për të përkufizuar qartësisht termin "Fëmijë i humbur" dhe përcaktimin e një procedure të kalimit nga fëmijë i larguar në fëmijë i humbur dhe i zhdukur;
- Trajtimin me emergjencë të çdo denoncimi për rastet e largimit të fëmijëve nga familja, dhe shpalljen e çdo fëmije "si të humbur" brenda 6 orëve që nga momenti kur nuk është gjetur fëmija, pavarësisht nëse është rast me precedent të përsëritur të largimit dhe jeta e fëmijës në dukje nuk është në rrezik;
- Të krijohet një rregjistër kombëtar për trafikuesit, shfrytëzuesit dhe abuzuesit e fëmijëve.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke krahasuar të dhënat zyrtare të Shqipërisë në lidhje me çështjet e fëmijëve të humbur me vendet e rajonit, situata duket më pak problematike por gjithsesi shifrat gjithnjë e në rritje thuajse të 6-fishuara në harkun e 5 viteve janë shumë shqetësuese.

Çështja e fëmijëve të humbur dhe larguar nga familja është çështje e të drejtave të njeriut. Gjatë viteve të fundit duhet pranuar se kjo çështje nuk ka patur vëmendjen e duhur. Çështja e fëmijëve të humbur duhet të kthehet në çështje prioritare veçanërisht për organet e zbatimit të ligjit. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të ndërmarrë hapat e duhur duke lëshuar urdhëra/qarkore/udhëzime për të sensibilizuar të gjithë zyrtarët dhe punonjësit e policisë për këto çështje.

- Qeveria duhet të angazhohet që të sigurojë sisteme të duhura që sigurojnë ndihmë ligjore, emocionale dhe financiare për familjarët e fëmijëve të humbur dhe larguar. Familjet e fëmijëve të cilët largohen periodikisht nga familja duhet të mbështeten nga institucionet publike dhe private por sidomos nga agjencitë ligjzbatuese me qëllim ndërtimin e një rrjeti mbrojtjeje.
- Rastet e fëmijëve të cilët largohen nga mjedisi familjar/kujdestar periodikisht dhe janë raste të njohura nga strukturat ligjzbatuese duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe nga ana e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.
- Të krijohen skuadrat e besimit komunitar për të zhvilluar hetime në komunitet në rastet e fëmijëve që denoncohen të humbur si një mekanizëm i marrjes së informacioneve të sigurta operative.
- Gjithashtu duhet të merren masa që policia të informojë periodikisht familjarët e fëmijëve të humbur në lidhje me ecurinë e hetimeve. Strukturat e policisë dhe njësitë që merren me çështjet e fëmijëve të humbur duhet të trajnohen periodikisht për teknikat specifike të hetimit dhe ndërhyrjes.
- Duhet të ofrohen shërbime multidisiplinare afatgjata për fëmijët e gjetur/rikthyer në mjedisin familjar.
- Marrja e padrejtë e fëmijës përbën volumnin më të madh të rasteve të trajtuara nga Policia e Shtetit. Strukturat ligjzbatuese duhet të jenë shumë të vëmëndshme ndaj dimensioneve

që po merr kjo vepër penale si dhe gjykatat në rastet e dhenies së kujdestarive duhet të saknsionojnë në mënyrë të theksuar pasojat për palët që shkelin vendimet e dhëna nga gjykatat. Gjithahstu në lidhje me marrjene padrejtë të fëmijëve duhet të rimendohet ashpërsimi i dënimeve në rastet e shkeljes së vendimeve.

- Fëmijët vajza përbëjnë dhe numrin më të madh të rasteve të fëmijëve të humbur/larguar nga mjedisi familjar me pothuajse dy-fishin e numrit të fëmijëve djem.

Numri I fëmijëve të humbur është rritur çdo vit me ritme shumë të shpejta dhe shumë shqetësuese ku nga 27 raste të trajtuara nga policia në vitin 2009 ka arritur në 149 raste të trajtuara nga policia në vitin 2014.

Situatat konfliktuale familjare, abuzimi fizik dhe emocional, neglizhimin përbëjnë edhe shkaqet më madhore që ndikojnë që fëmijët të largohen nga mjedisi familjar/kujdestar.

7. A I KENI PARË KËTA FËMIJE?

Bleona Mata

Tipi i Rastit: Rrembim Jo nga Familja

Ditelindja: 29.08.2003

Data e Humbjes: 2010-05-22

Gjinia: Femer Mosha aktuale: 12 vjec

Qyteti nga ka humbur: ZAPOD

Ngjyra e Flokeve: Kafe

Ngjyra e Syve: Te zinj



Mirjeta Nela

Vendlindja: Greiskirchen, Austri

Shtetesia: Austriake

Gjinia: Femer

Datëlindja e fëmijës: Viti 2005

Mosha aktuale: 10 vjeç

Ngjyra e flokëve: Geshtenje

Ngjyra e syve: Blu te medhenj


Gjatësia: rreth 1.15 m

Shenja dalluese të fëmijës: Ka një hapësirë të vogël ndërmjet dhëmbëve përpara

Data e humbjes: Viti 2008 Tipi i rastit: Dyshohet për rrembim prindëror nga babai

Vendndodhja: Dyshohet se ndodhen ne Shqiperi

Emri i babait: Shaqir Matmuja



Isa Nela

Emri: Isa Mbiemri: Nela

Vendlindja: Greiskirchen, Austri

Shtetesia: Austriake

Gjinia: Mashkull

Datëlindja e fëmijës: Viti 2005

Mosha aktuale: 10 vjeç

Ngjyra e flokëve: Biond

Ngjyra e syve: Kafe

Gjatësia: rreth 1.25 m

Shenja dalluese të fëmijës: tipare te plota, tipare te rregullta, rrumbullaket ne fytyre

Data e humbjes: Viti 2008

Qyteti: Greiskirchen, Austri

Tipi i rastit: Dyshohet për rrembim prindëror nga babai

Vendndodhja: Dyshohet se ndodhen ne Shqiperi

Emri i babait: Shaqir Matmuja



Marteo Bejaj

Emri: Mateo

Mbiemri: Bejaj

Mosha aktuale: 17 vjeç


Vendlindja: Fitore, Vlore

Shtetësia: Shqiptare

Kombësia: Shqiptare

Të dhëna identifikuese: Tipare te rregullta, fytyre te rrumbullaket, floke ngjyre te zeza.

Është parë për herë të fundit ditën e shtunë datë 16. 07. 2011 ne fshatin Fitore Vlore.



Juljan Çela

Emri: Julian

Mbiemri: Çela

Vendlindja: Tirane

Gjinia: Mashkull

Datëlindja e fëmijës: 09 Maj 2002

Ngjyra e flokëve: E zeze

Ngjyra e syve: e zeze

Gjatësia: rreth 1.50 m

Shenja dalluese të fëmijës: tipare te plota, tipare te rregullta, rrumbullaket ne fytyre

Data e humbjes: 30 Nëntor 2012

Qyteti: Tirane Qyteza apo fshati: Laprake, Tirane



Për secilin nga këto raste kushdo që ka informacion mund të telefonojë çdo ditë pranë Linjës Kombëtare për Fëmijët e Humbur në numrin 116 000 ose mund të dërgojë email tek adresa alo116@crca.al

ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës I cili ofron:

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

ALO 116, si një shërbim kombëtar në ndihmë të fëmijëve, mbështetet nga UNICEF Shqipëri:



ALO 116 mbështetet nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
- Avokati i Popullit
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

dhe këto kompani të telefonisë në Shqipëri:

